



BASHKIA HIMARË ANGAZHOHET PËR FUQIZIMIN E MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Bashkia Himarë ndërmerr një angazhim të ri për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, ngritur në vitin 2017, me mbështetjen e UNDP Shqipëri. Ky Mekanizëm që ka rreth dy vjet që trajton të gjitha rastet e dhunës në familje përmes qasjes së koordinuar shumë-sektoriale të institucioneve përgjegjëse, ka nevojë që të fuqizohet për një trajtim sa më efektiv të rasteve të paraqitura, në përputhje edhe me ndryshimet më të fundit ligjore në këtë drejtim.

Është fakt që pavarësisht se është punuar në këtë drejtim, - thekson Kryetari i bashkisë z. Jogo Goro, - kemi ende shumë për të bërë si për të rritur efektivitetin ashtu dhe për ta shtrirë modelin e punës në të gjitha njësitet administrative të Bashkisë Himarë. Mbështetja dhe bashkëpunimi i institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Himarë, por që janë të vendosura në Vlorë, është deciziv në këtë drejtim!

Në projektin e ri që u nënshkrua në fund të tetorit 2019 për këtë qëllim, ndërmjet Bashkisë Himarë dhe UNDP Shqipëri, është rënë dakord që Bashkia do të vijojë punën e saj për fuqizimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit përmes: a) plotësimit të detyrimit për riaktivizimin e Komitetit Drejtues të këtij Mekanizmi; b) caktimit të një punonjëseje në pozicionin e Koordinatorës Vendore kundër Dhunës në Familje; c) organizimit të mbledhjeve të rregullta të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor; d) trajnimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të përfaqësuesve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor; e) trajtimit të rasteve me efektivitet dhe përgjegjshmëri maksimale; f) informimit dhe edukimit të publikut përmes aktiviteteve të ndryshme të vazhdueshme; g) ofrimit të shërbimeve konkrete për mbulimin e nevojave për rastet emergjente, etj. Mbështetja e ofruar nga PNUD për këtë qëllim është në vlerën **876,200 Lekë**, ndërkohë që vetë bashkia kontribuon në vlerën **472,444 lekë** përmes: a) punës dhe angazhimit të punonjëseve e punonjësve të tjerë të bashkisë; b) vënies në dispozicion të ambjentëve dhe mjeteve të nevojshme për organizimin e takimeve dhe trajnimeve të planifikuara; c) organizimit dhe moderimit të aktiviteteve të ndryshme në bashkëpunim me antarët e tjerë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, etj.

Zbatimi i këtij projekti përgjatë dymbëdhjetë muajve në vijim, do të shoqërohet me publikime të here pas here të aktiviteteve që do planifikohen e zhvillohen, si dhe të rezultateve që do të arrihen.

Projekti u përgatit nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë z. Jogo Goro dhe mbështetet nga UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara, "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë.